



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
Nr. I fag. _____
Gj. str. _____
Nr. pages _____

Nr. Prot. _____
Br. Prot. _____
Prot. No. 03-03/398/17
Data _____
Datum _____
Date 20-02-2017
PRISHTINE

DATË/A:	20/02/2017
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Bujar KUÇI Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Suharekës
CC:	z. Sali ASLLANAJ Kryetar i Komunës në Komunën e Suharekës
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve zyrtare "

I nderuari z. Kuçi,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " **Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve zyrtare** " me numër prokurimi: 624-17-108-221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve zyrtare** " me numër prokurimi: 624-17-108-221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04/L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsy etimi

Komuna e Suharekës, përmes zyrës së prokurimit ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull "**Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve zyrtare**" me numër prokurimi: 624-17-108-221i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.02/02/2017. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në fushën e Prokurimit Publik (DPKPP) sipas detyrës zyrtare ka identifikuar dhe trajtuar këtë procedurë të prokurimit. Gjatë shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumenteve të dosjes së këtij tenderi, AKK ka hasur në disa dhëna të cilat nuk janë në pajtim me Legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik. Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e ofruar nga ana e Autoritetit kontraktues ka konstatuar faktet si në vijim:

Në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit e cila është përgatitur nga ana e Autoritetit Kontraktues, tek rubrika III.2.4) Kapacitetet teknike dhe profesionale pika 3 është kërkuar: Operatori Ekonomik duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme të objektit minimum 100m² në një distancë jo më larg se 15km nga Objekti i Komunës së Suharekës. Kërkesë kjo për të cilën Agjencia konsideron se është diskriminuese dhe kufizon konkurrencën e lire në mesin e Operatorëve Ekonomik.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Suharekës me formulimin e kësaj kërkesë në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit ka bërë Diskriminim territorial në kundërshtim me ligjin në fuqi për Prokurim Publik ku thuhet se Autoriteti Kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik, duke diskriminuar Operatorët Ekonomik që janë në largësi më tepër se 15km dhe duke favorizuar Operatorët Ekonomik që janë me afër se 15 km.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 20 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon korrigjimin e gabimeve të kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !